

Analizë krahasuese e politikave dhe iniciativave të Edukimit mbi Median dhe Informacionin (EMI) në Shqipëri me vendet e sukseshme në këtë fushë (Finlanda)

Marina Zela

(Shqyrtuar dhe mbikqyrur nga: Prof. Erlis Çela)

Punimi është realizuar si pjesë e projektit “Edukimi për Median dhe Informacionin në universitetet shqiptare: Nga pilotimi në zbatim,” të mbështetur financiarisht nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun të Ambasadës së SHBA në Tiranë. Opinione, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit.

Abstrakt

Në një kohë ku përdorimi i të gjitha medimeve dhe fluksi i informacionit po luajnë një rol vendimtar në mënyrën se si njerëzit e perceptojnë botën dhe veprojnë në të, edukimi për median dhe informacionin (EMI) duket se është shndërruar në një element të domosdoshëm në zhvillimin e shoqërive demokratike. Disa vende kanë qenë mjaft të suksesshme në implementimin e politikave por dhe integrimin në kurrikula arsimore në lidhje me këtë çështje. Ndërkohë Shqipëria duket se po vazhdon të përballlet me sfida të shumta në lidhje me përfshirjen e EMI-it në kurrikulat arsimore.

Ky studim synon të ofrojë një analizë krahasuese të politikave dhe praktikave të EMI-t në Shqipëri dhe iniciativave në vende, që kanë treguar sukses në këtë fushë, siç janë vendet nordike. Përmes një rishikimi të imtësishëm të literaturës, një analize krahasuese me politika të ndryshme që kanë pasur sukses dhe një analize sasiore me studiues të medias në Finlandë dhe mësues të arsimit të mesëm në Shqipëri, studimi synon të identifikojë qasjet më të mira dhe të propozojë zgjidhje për përmirësimin e politikave. Në këtë mënyrë mund të kemi dhe një rritje ndërgjegjësimit në lidhje me rëndësinë e EMI-t dhe zhvillimin e aftësive kritike të qytetarëve për tu përballur me mjedisin e vështirë mediatik në të cilin tashmë jetojmë.

Fjalë kyce: EMI, politika, arsim, media, integrim, përmirësim, edukim.

Hyrje

Në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur dhe të dominuar nga teknologjia, Edukimi për Median dhe Informacionin(EMI) po kthehet në një kompetencë thelbësore për qytetarët e këtij shekulli. Ndërveprimi me mediat dixhitale, të cilat integrojnë printimin tradicional (gazeta, revista), audiovizualen dhe teknologjitë kompjuterike, kërkon aftësi të reja për të analizuar, vlerësuar dhe krijuar mesazhe në kontekste të ndryshme (Frau-Meigs, 2008). Në këtë kuadër, EMI shërben si një mjet i fuqishëm për të zhvilluar kompetenca qytetare, për të nxitur kreativitetin dhe për të fuqizuar individët në një mjedis mediatik gjithnjë e më kompleks (Livingstone, 2011).

Megjithatë, edhe mjedisi mediatik ndryshon bazuar në kontekstin politik, social dhe kulturor të një shteti. Si rrjedhojë, edhe sfidat në përpjekjet për integrimin e EMI-t në shoqëri janë të ndryshme. Në vendet nordike, ku EMI është integruar në mënyrë të suksesshme në kurrikulat arsimore, politikat mbi edukimin mediatik kanë rezultuar në rritjen e kompetencave dixhitale

dhe fuqizimin e qytetarëve përmes pjesëmarrjes aktive dhe etikës digjitale (Carlsson, 2010). Këto politika demonstrojnë rëndësinë e një qasjeje holistike që përfshin mbështetjen institucionale dhe bashkëpunim ndërmjet sektorëve të ndryshëm (Kupiainne, 2011).

Nga ana tjetër, sfidat në vendet si Shqipëria përfshijnë mungesën e politikave të qarta dhe integrimin e pamjaftueshëm të EMI-t në sistemin arsimor. Niveli i ulët i njohurive mbi median dhe informacionin në Shqipëri nxjerr në pah nevojën për strategji më të qarta dhe mbështetje të vazhdueshme për zhvillimin e EMI-t në nivele të ndryshme arsimore (Çela et al., 2022). Ky hendek ndërmjet vendeve tregon se politika të qarta dhe të qëndrueshme janë thelbësore për të siguruar që EMI të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e shoqërive demokratike.

Studimet ndërkombëtare tregojnë se një qasje e balancuar dhe e mirëprojektuar ndaj EMI-t mund të ndihmojë në rritjen e angazhimit qytetar dhe politik. Në Belgjikë studiuesit kanë dokumentuar sesi diskutimet parlamentare mbi EMI-n janë shndërruar në politika publike gjithëpërfshirëse (Audenhove & Vanwynsberghe, 2018). Për më tepër, ndërhyrjet edukative mund të jenë të suksesshme kur adresojnë jo vetëm aftësitë teknike, por edhe aspektet etike dhe kulturore të përdorimit të mediave (Byrne, 2009).

Në këtë drejtim, EMI nuk është vetëm një aftësi teknike, por edhe një mjet për të nxitur pjesëmarrjen demokratike dhe qëndrueshmërinë sociale. Studiuesit Kellner dhe Share, theksojnë se edukimi mediatik duhet të shërbejë si një platformë për sfidimin e strukturave ekzistuese të pushtetit dhe për të ndërtuar një shoqëri më të drejtë (Kellner & Share, 2007a). Kjo përfshin analizimin kritik të mesazheve mediatike dhe krijimin e kapaciteteve për të interpretuar informacionin në mënyrë të saktë dhe të ndërgjegjshme (Kahne & Bowyer, 2019).

Në këtë punim synohet të shqyrtohen sfidat dhe mundësitë e implementimit të EMI-t në Shqipëri përmes një analize krahasuese me modele të suksesshme ndërkombëtare, me theks të veçantë në Finlandë. Duke u bazuar në teoritë bashkëkohore mbi EMI-n dhe përvojat praktike nga vende si Finlanda, analizohen faktorët që ndihmojnë ose pengojnë zhvillimin e aftësive mediatike për median dhe informacionin. Ky studim synon jo vetëm të identifikojë boshllëqet, por edhe të propozojë qasje që mund të përshtaten për të forcuar politikatat arsimore dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e edukimit mediatik në formimin e qytetarëve kritikë dhe të ndërgjegjshëm.

Hipoteza:

Iniciativat e Edukimit për Median dhe Informacion (EMI) në Shqipëri janë më pak efektive krahasuar me praktikatat ndërkombëtare për shkak të integrimit të kufizuar në kurrikulat arsimore dhe mungesës së mbështetjes nga qeveria.

Pyetje Kërkimore:

1. Çfarë iniciativash janë ndërmarrë për të integruar Edukimin për Median dhe Informacionin (EMI) në sistemin e arsimit në Shqipëri?
2. Si krahasohen iniciativat për EMI-në në sistemin arsimor shqiptar me praktikatat e suksesshme në vende si Finlanda?
3. Cilat janë sfidat kryesore që pengojnë integrimin efektiv të EMI-t në shkollat shqiptare dhe si mund të adresohen ato?

Metodologjia

Për realizimin e këtij punimi është përdorur një qasje cilësore për të shqyrtuar sfidat dhe mundësitë e implementimit të Edukimit për Median dhe Informacionin (EMI) në Shqipëri, duke e krahasuar me përvojat e suksesshme në Finlandë. Metodologjia bazohet në tre komponentë kryesorë: rishikim të literaturës, analizë krahasuese dhe intervista të strukturuar. Fillimisht, është kryer një rishikim i gjerë i literaturës ekzistuese mbi EMI-në për të identifikuar konceptet kryesore, politikatat dhe praktikatat e suksesshme ndërkombëtare. Burimet përfshijnë artikuj shkencorë, raporte dhe publikime nga vende me përvoja të konsoliduara në EMI, si Finlanda dhe vendet nordike. Ky rishikim ndihmon në krijimin e një baze teorike për të kuptuar ndikimin e EMI-t në formimin e aftësive kritike dhe pjesëmarrjen qytetare.

Së dyti, analiza krahasuese midis Shqipërisë dhe Finlandës fokusohet në kurrikulat arsimore dhe integrimin e EMI-t në sistemin arsimor. Për këtë qëllim, janë shqyrtuar dokumente zyrtare, plane mësimore dhe strategji të institucioneve përkatëse. Analiza synon të identifikojë ndryshimet kryesore në qasjet arsimore të të dy vendeve, duke u përqendruar në nivelin e përfshirjes së EMI-t në kurrikulat përkatëse.

Komponenti i tretë i metodologjisë përfshin kryerjen e dy intervistave të strukturuar. E para është realizuar me një mësuese të gjuhëve të huaja në Shqipëri, për të kuptuar sfidat dhe përvojat praktike në qasjet ndërdisiplinore të EMI-t në mësimdhënie. Intervista e dytë është kryer me një Phd. Candidate dhe studiuese në Finlandë, e cila ka njohuri të thelluara mbi implementimin e EMI-t në këtë vend dhe ka përfunduar një master në Digital Media Literacy.

Përmes këtyre intervistave, është synuar të mblidhen të dhëna cilësore që pasqyrojnë perspektiva të ndryshme, duke ofruar një panoramë më të plotë mbi ndikimin e EMI-t në sistemet arsimore të të dy vendeve. Pyetjet e intervistave janë dizajnuar për të eksploruar temat si: përfshirja e EMI-t në kurrikula, roli i qeverisë dhe sfidat kryesore që hasen në terren.

Nëpërmjet kësaj metodologjie, studimi synon të kontribuojë në zhvillimin e qasjeve më të mira për implementimin e EMI-t në Shqipëri, duke ofruar rekomandime të bazuara në praktikat më të mira ndërkombëtare.

Rishikim Literature

Për realizimin e këtij punimi janë shqyrtuar disa lloje literaturash për të pasur një këndvështrim më të gjerë mbi temën.

Divina Frau-Meigs, profesoreshë e Medias dhe Sociologjisë së Komunikimit Teknologjik, në universitetin e Sorbonne Nouvelle në Francë, thekson rëndësinë e edukimit mediatik si një element kyç për ndërtimin e shoqërive të qëndrueshme. Ajo argumenton se edukimi mbi median nuk është thjesht një aftësi teknike, por një komponent thelbësor për të drejtat njerëzore dhe për zhvillimin e qëndrueshëm global. Në këtë kontekst, edukimi mediatik perceptohet si një mënyrë për të fuqizuar individët dhe për të nxitur angazhimin qytetar (Frau-Meigs, 2008).

Nga ana tjetër, akademiku amerikan *Douglass Kellner*, i cili është dhe një ndër teroicienët e parë të “critical media literacy”, sëbashku me *Jeff Share*, profesor në universitetin e Kalifornisë, ofrojnë një kuadër për edukimin mediatik, duke propozuar qasje që nxisin mendimin kritik dhe analizën e strukturave sociale në media. Sipas tyre, EMI është thelbësor për të ndihmuar individët të kuptojnë rolin e medias në formimin e botëkuptimeve dhe të marrin vendime të informuara (Kellner & Share, 2007b).

Një literaturë mjaft e rëndësishme për këtë punim ka qenë dhe ai nga Prof. Assoc *Anna-lene Godhe*, e cila analizon konceptualizimet e kompetencave dixhitale në kurrikulat nordike, duke theksuar lidhjen midis edukimit mediatik dixhital dhe kompetencave qytetare. Ajo vëren se vendet nordike kanë një qasje holistike që përfshin pjesëmarrjen aktive dhe kreativitetin në mjediset dixhitale. Sipas studiueses, ky model është një shembull i fuqishëm për vendet që kërkojnë të përmirësojnë EMI-n përmes integritit të tij në sistemet arsimore (Godhe, 2019).

Ndërkohë dy studiuese nga Finlanda na japin një qasje më gjithëpërfshirëse mbi politikat e ndjekura në këtë vend. *Sirkku Kotilainen* profesoreshë në universitetin Tampere dhe *Sol-Britt Arnolds-Granlunds*, lektore në Abo Academy, shqyrtojnë politikat e edukimit mediatik në

Finlandë, duke treguar për qasjet e suksesshme që vendi ka ndjekur për të integruar EMI-n në sistemin arsimor. Këto studime nënvizojnë rëndësinë e mbështetjes institucionale dhe të partneriteteve ndërmjet qeverisë, shkollave dhe organizatave të shoqërisë civile (Kotilainen & Arnolds-Granlund, 2010 dhe Kupiainen, 2011).

Gjithashtu një qasje më ndryshe na ofron *Robert J. Graham*, profesor në univeristetin e Miami-t. Ai e lidh edukimin mediatik me politikën kulturore, duke theksuar se EMI është një mjet për të sfiduar normat dhe për të ndërtuar një shoqëri më të drejtë. Ai nënvizon se edukimi mediatik duhet të shërbejë jo vetëm për të pajisur individët me aftësi teknike, por edhe për t'i ndihmuar ata të kuptojnë dhe sfidojnë strukturat e pushtetit në media (Graham, 1989).

Të njëjtën qasje argumentojnë dhe studiuesit amerikanë *Joseph Kahne* dhe *Benjamin Bowyer*, të cilët shprehen se edukimi mediatik mund të rrisë angazhimin dixhital në politikë. Përmes hulumtimeve të tyre, ata zbulojnë se EMI mund të ndihmojë qytetarët të kuptojnë më mirë informacionin politik dhe të angazhohen në mënyrë më aktive në proceset demokratike (Kahne & Bowyer, 2019).

Më pas, një studim nga disa studiues në univeristetin e Tajvanit, eksploron zhvillimin e instrumenteve për matjen e edukimit mediatik. Ky studim kontribuon në kuptimin e mënyrës sesi individët mësojnë të navigojnë në një mjedis gjithnjë e më të ndërlikuar dixhital (Lee et al., 2015).

Po ashtu dhe Prof. Asoc *Grzegorz Ptaszek*, nga univeristeti i Krakow në Poloni, propozon një qasje për matjen e rezultateve të edukimit mediatik. Ai thekson rëndësinë e përdorimit të qasjeve multidimensionale për të vlerësuar efektivitetin e EMI-t në zhvillimin e aftësive kritike dhe krijuese të individëve (Ptaszek, 2019)

Më tej, një raport i realizuar nga UNESCO, prezanton *Kornizën Globale të Vlerësimit të Edukimit Mediatik dhe Informativ*, e cila synon të vlerësojë gatishmërinë dhe kompetencat e vendeve në këtë fushë. Dokumenti thekson rëndësinë e integritit të EMI-t në politikën arsimore dhe nënvizon nevojën për qasje gjithëpërfshirëse që përfshijnë qeverinë, institucionet arsimore dhe shoqërinë civile. Ai ofron gjithashtu udhëzime për matjen e rezultateve, duke nxitur zhvillimin e kompetencave kritike dhe të pjesëmarrjes aktive në shoqëri (UNESCO, 2013).

Ndërkohë për një qasje më vendase i jemi referuar si literaturë studimit të realizuar nga *Instituti Shqiptar i Medias*, ku trajtohen politikën dhe strategjitë kombëtare që lidhen me edukimin për median dhe informacionin në Shqipëri. Ky raport thekson se, ndonëse Edukimi për Median dhe

Informacionin (EMI) është njohur si një aspekt i rëndësishëm në zhvillimin e aftësive qytetare dhe kritike, integrimi i tij në Shqipëri mbetet i kufizuar. Një nga sfidat kryesore të evidentuara është mungesa e një kornize të qartë politike dhe mbështetja e pamjaftueshme nga institucionet shtetërore. Në studimin nga Instituti Shqipëtar i Medias sugjerohet se është e domosdoshme që EMI të integrohet në mënyrë sistematike në kurrikulat arsimore dhe të mbështetet nga partneritete të qëndrueshme ndërmjet institucioneve arsimore, qeverisë dhe organizatave të shoqërisë civile për të arritur rezultate të prekshme dhe të qëndrueshme. (Media Institute, n.d.)

Gjithashtu, dhe studimi “Zhvillimi i shkallës dhe matja e nivelit të edukimit mbi median dhe informacionit të studentëve në Shqipëri”, po nga autorë vendas si *Çela, Tufa dhe Danglli*, shqyrton nivelin e edukimit mbi median dhe informacionin në Shqipëri, duke vënë në dukje sfidat që studentët përballen në mjediset arsimore. Studimi në fjalë evidenton se mungesa e politikave të qarta dhe integrimi i pamjaftueshëm i EMI në kurrikulat arsimore ndikon në zhvillimin e aftësive kritike të studentëve (Çela, Tufa & Danglli 2022).

Krahasim i politikave të ndërmarra në lidhje me EMI-n, Shqipëri dhe Finlandë

Edukimi për Median dhe Informacionin (EMI) është një komponent thelbësor për të ndihmuar qytetarët të përballen me sfidat e një mjedisi mediatik gjithnjë e më kompleks. Megjithatë, qasjet dhe politikat për zbatimin e EMI-t ndryshojnë ndjeshëm nga një vend në tjetrin. Ky seksion krahasues shqyrton politikat e ndërmarra nga Shqipëria dhe Finlanda, duke analizuar masat specifike që i dallojnë këto vende në qasjen e tyre.

Politikat dhe qasjet në Shqipëri

Në Shqipëri, përpjekjet për të integruar edukimin për median dhe të informacionin (MIL/EMI) në sistemin arsimor kanë filluar që nga viti 2021. UNESCO, në bashkëpunim me Institutin Shqiptar të Medias dhe Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve, nisi pilotimin e EMI-t në arsimimin formal. Projekti patjetër që ishte një hap i rëndësishëm drejt integritit të EMI-t në programin mësimor zyrtar, duke adresuar nevojën për strategji sistematike dhe afatgjatë në edukimin mediatik, por sfidat janë të mëdha. Sipas Institutit Shqiptar të Medias strategjitë kombëtare mbi EMI-n janë sporadike dhe shpesh të varura nga projektet e përkohshme të organizatave ndërkombëtare. Për shembull, disa trajnime për mësuesit dhe nxënësit janë realizuar për të rritur ndërgjegjësimin mbi përdorimin kritik të mediave, por këto nisma nuk janë pjesë e një strategjie kombëtare të qëndrueshme. EMI nuk është integruar plotësisht në kurrikulat arsimore, duke lënë shumicën e nxënësve dhe mësuesve pa njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të naviguar në mënyrë kritike në mjedisin mediatik (Çela et al., 2022).

Një problem tjetër i theksuar është mungesa e mbështetjes institucionale dhe financiare për EMI. Shqipëria ende nuk ka një kornizë politike që të sigurojë zhvillimin dhe zbatimin e qëndrueshëm të EMI. Për më tepër, ndonëse projekte të izoluara kanë arritur të përmirësojnë aftësitë e disa grupeve specifike, ato nuk kanë ndikuar në krijimin e një ndryshimi strukturor dhe të gjerë në sistemin arsimor.

Politikat dhe qasjet në Finlandë

Në kontrast, Finlanda ka një histori të gjatë dhe të suksesshme në zhvillimin dhe implementimin e EMI. Një nga politikat kryesore që e dallon Finlandën është përfshirja e EMI si pjesë e kompetencave bazë në kurrikulën kombëtare që nga viti 2014. Kjo politikë përfshin zhvillimin e aftësive për të analizuar, vlerësuar dhe krijuar përmbajtje mediatike, si dhe për të promovuar etikën dhe përgjegjësinë dixhitale (Carlsson, 2010).

Finlanda gjithashtu ka krijuar një program të strukturuar për trajnimin e mësuesve në EMI. Mësuesit marrin udhëzime të detajuara dhe burime specifike për të integruar EMI në mësimdhënie, qoftë në lëndë si gjuha dhe shkencat sociale, qoftë në lëndë teknike dhe artistike. Përveç kësaj, Finlanda ka zhvilluar një platformë kombëtare që ofron burime falas për shkolla, duke përfshirë materiale mësimore dhe mjete për zhvillimin e mendimit kritik. Ky model siguron që nxënësit në të gjithë vendin të kenë akses të barabartë në burime për zhvillimin e aftësive mediatike.

Një tjetër masë konkrete është mbështetja e vazhdueshme institucionale për EMI-n. Qeveria finlandeze ka siguruar financime të qëndrueshme për programet e edukimit mediatik, duke krijuar një mjedis që inkurajon bashkëpunimin midis shkollave, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve të tjera publike.

Krahasimi dhe rekomandimet për Shqipërinë

Krahasimi midis Shqipërisë dhe Finlandës nxjerr në pah qasje dhe rezultate të ndryshme. Finlanda ka treguar se integrimi sistematik i EMI në kurrikulën kombëtare dhe mbështetja e qëndrueshme institucionale janë kyçe për suksesin. Shqipëria, nga ana tjetër, duhet të ndër marrë hapa konkretë për të institucionalizuar EMI-n në sistemin e saj arsimor.

Një nga mësimet kryesore që Shqipëria mund të marrë nga Finlanda është rëndësia e zhvillimit të një kornize kombëtare për EMI, që përfshin trajnimin e mësuesve dhe sigurimin e burimeve të qasshme për të gjitha shkollat. Gjithashtu, krijimi i një platforme dixhitale për EMI-n do të ndihmonte në standardizimin dhe përhapjen e njohurive mediatike në të gjithë vendin. Përvoja

e Finlandës tregon gjithashtu se bashkëpunimi midis qeverisë, institucioneve arsimore dhe shoqërisë civile është thelbësor për zbatimin e suksesshëm të EMI.

Ndërsa Shqipëria përballet me sfida të shumta, përvoja e Finlandës ofron një model konkret për ndërtimin e një strategjie të qëndrueshme për edukimin mediatik dhe informativ. Duke ndjekur shembullin finlandez, Shqipëria mund të krijojë një sistem arsimor që promovon mendimin kritik, etikën mediatike dhe kompetencat qytetare për të përballuar sfidat e një mjedisi dixhital gjithnjë e më të ndërlikuar.

Analizë e intervistave të strukturuar

Intervista me një mësuese të gjuhëve të huaja në Shqipëri dhe një studiuese të Digital Media Literacy në Finlandë (Tampere University in Finland)

Nëpërmjet dy intervistave të realizuara me një mësuese të gjuhës angleze në Shqipëri, Erlinda Samurri, dhe me një kandidate për doktoraturë në Finlandë, Sophie Nhat Nguyen, e cila ka mbaruar dhe një master shkencor në lidhje me Digital Media Literacy, u mundësua një krahasim mbi përvojat dhe sfidat që lidhen me EMI-n në dy sisteme arsimore të ndryshme. Të dyja intervistat u fokusuan në përvojën dhe njohuritë e individëve mbi përdorimin e mediave në mësimdhënie, sfidat që hasen në implementim dhe mundësitë për përmirësim.

Një ndër pyetjet e para për të dyja intervistat ishte në lidhje me kurset apo aktivitetet që ata kanë ndjekur, të cilat kanë lidhje me edukimin mediatik. Erlinda, duke qenë pjesë e një shkolle që nuk ka një kurrikul të zhvilluar për EMI-n, theksoi se ajo përdor mediat në mësimdhënie në mënyrë të natyrshme, por që nuk ka pasur mundësi të marrë trajnime formale në lidhje me EMI-n. Ajo shpjegoi se edukimi mbi mediat duhet të jetë një pjesë e integruar në aktivitetet mësimore përmes analizave të teksteve dhe diskutimeve, duke u përpjekur të zhvillojë aftësi kritike tek nxënësit, por nuk ka pasur një fokus të dedikuar në këtë çështje. Nga ana tjetër, PhD. Candidate Sophie nga Finlanda përmend trajnimin e saj të avancuar në mediat digjitale, duke theksuar se në Finlandë, EMI është pjesë e kurrikulave kombëtare në të gjitha nivelet, dhe se ajo ka pasur mundësi të marrë pjesë në kurse të specializuara për përdorimin e mediave dhe zhvillimin e aftësive kritike në përdorimin e tyre. Ajo shprehet se gjatë studimeve master, programi vuri theksin në zgjidhjen inovative të problemeve në praktikë. Sophie tregon se një moment kulmor ishte bashkëorganizimi i SOMEJAM, një hackathon i fokusuar në jetën dixhitale të qëndrueshme për të rinjtë. Kjo përvojë e mësoi të punonte në mënyrë bashkëpunuese për të krijuar zgjidhje për sfida si mbingarkesa mediatike dhe dezinformimi, aftësi që janë thelbësore në peizazhin e sotëm mediatik kompleks.

Në lidhje me pyetjen për suksesin e Finlandës në implementimin e EMI-t, të dyja intervistat i japin përgjigje të ngjashme, por me theks të ndryshëm. Erlinda vuri në dukje se një faktor kyç për suksesin e Finlandës ka qenë përkushtimi i qeverisë dhe investimi në trajnimin e mësuesve. Ajo mendon se Shqipëria mund të përmirësohet duke pasur një kornizë të qartë dhe një mbështetje të mëtijshme nga institucionet për zhvillimin e EMI-t. Sophia, nga ana tjetër, theksoi se një element tjetër i rëndësishëm ka qenë mbështetja e vazhdueshme që mësuesit kanë marrë nga qeveria për të zhvilluar materiale mësimore dhe për të përdorur teknologjinë në mënyrë të sigurt. Ajo e shpjegon këtë sukses si një përpjekje të koordinuar mes institucioneve edukative dhe qeverisë për të siguruar një implementim të suksesshëm dhe të qëndrueshëm të EMI-t në shkolla.

Në fund, për të dyja intervistat, pyetja e fundit u fokusua në atë që mund të bëjnë shtetet si Shqipëria për të pasur një implementim të suksesshëm të EMI-t, si Finlanda. Erlinda sugjeroi që Shqipëria duhet të krijojë një kornizë më të fortë ligjore dhe të rrisë mundësitë për trajnime të mësuesve. Sophie thekson se për të arritur suksesin e Finlandës, shtetet duhet të investojnë në zhvillimin e aftësive mediatike dhe të krijojnë mundësi për mësuesit të përmirësojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre. Ajo shtoi se promovimi i mësimit gjatë gjithë jetës, zhvillimi i qasjeve bashkëpunuese dhe përqendrimi në mendimin kritik dhe qëndrueshmërinë janë faktorë ndikues në procesin e integritit të EMI-t në kurrikula.

Përfundime dhe rekomandime

Në një botë të dominuar nga teknologjia, dezinformimi dhe përhapja e lajmeve të rreme është krijuar një mjedis sfidues që kërkon ndërhyrje të menjëhershme. Edukimi për Median dhe Informacioni nuk është më një luks; është një domosdoshmëri për të gjitha grupmoshat dhe kategoritë sociale.

Mungesa e përfshirjes së EMI-t në sistemin arsimor shqiptar mbetet një nga pengesat më të mëdha për të zhvilluar aftësi kritike në nxënës dhe qytetarë. Edukimi formal ende nuk ka arritur të përfshijë këtë koncept në mënyrë sistematike, duke lënë shumë individë të papërgatitur për të përballuar sfidat që shoqërojnë epokën digjitale. Përveç kësaj, mungesa e burimeve dhe trajnimeve për mësuesit kufizon aftësinë e tyre për të përçuar njohuri dhe aftësi mbi këtë temë.

Nga një perspektivë sociale, edukimi për EMI-n mund të jetë një mjet i fuqishëm për të adresuar polarizimin politik dhe social, duke promovuar dialog të hapur dhe mirëkuptim ndërmjet

grupeve të ndryshme. Për më tepër, përfshirja e EMI-t në arsimin formal dhe joformal mund të kontribuojë në fuqizimin e grave dhe të rinjve, të cilët shpesh janë më të ndjeshëm ndaj ndikimeve negative të mediave.

Bazuar në këto përfundime, rekomandimet e mëposhtme janë propozuar për të adresuar sfidat dhe për të promovuar Edukimin për Median dhe Informacionin në Shqipëri:

Përfshirja e EMI-t në kurrikulën zyrtare të arsimit parauniversitar dhe universitar është një hap i domosdoshëm. Ky integrim duhet të bëhet në mënyrë të strukturuar, duke siguruar që nxënësit të mësojnë aftësi kritike për të analizuar, kuptuar dhe përdorur informacionin. Lëndët si “Teknologjia e Informacionit” dhe “Qytetaria” mund të plotësohen me module për EMI-n, duke ndihmuar nxënësit të përgatiten për sfidat e botës digjitale.

Për të siguruar një zbatim efektiv të EMI-t, është thelbësore të trajnohen mësuesit dhe edukatorët. Ministria e Arsimit dhe organizatat joqeveritare duhet të bashkëpunojnë për të krijuar programe trajnimi që ndihmojnë mësuesit të integrojnë EMI-n në metodat e tyre të mësimdhënies.

Përtej sistemit arsimor, është e nevojshme që qytetarët e rritur të ndërgjegjësohen mbi rëndësinë e EMI-t. Fushatat kombëtare të ndërgjegjësimit, të mbështetura nga qeveria dhe mediat, mund të ndihmojnë në edukimin e publikut për rreziqet e dezinformimit dhe përfitimet e një qasjeje kritike ndaj mediave.

Mediat dhe sektorët privatë kanë një rol të rëndësishëm në promovimin e EMI-t. Mediat duhet të kontribuojnë duke ofruar programe edukative dhe përmbajtje të cilësisë së lartë, ndërsa bizneset mund të ndihmojnë përmes sponsorizimeve për projekte dhe nisma.

Zbatimi i programeve për EMI-n duhet të monitorohet dhe vlerësohet rregullisht për të siguruar se ato janë efektive dhe adresojnë nevojat reale të qytetarëve. Ky proces do të ndihmojë në identifikimin e sfidave të reja dhe në përshtatjen e strategjive ekzistuese.

Në përfundim, Edukimi për Median dhe Informacionin është një domosdoshmëri për të përballuar sfidat e shoqërisë moderne. Vetëm përmes një angazhimi të përbashkët midis qeverisë, sistemit arsimor, mediave dhe publikut, Shqipëria mund të zhvillojë një shoqëri më të qëndrueshme, më të drejtë dhe më të informuar. Implementimi i rekomandimeve të

mësipërme do të jetë një hap i rëndësishëm për të arritur këtë qëllim dhe për të siguruar që çdo qytetar të ketë aftësitë e nevojshme për të marrë vendime të përgjegjshme dhe të informuara.

Bibliografia

- Audenhove, L. Van, & Vanwynsberghe, I. M. (2018). Media Literacy Policy in Flanders Belgium: From Parliamentary Discussions to Public Policy. *Journal of Media Literacy Education*.
- Media Institute, A. (n.d.). *Albanian Media Institute Instituti Shqiptar i Medias Politikat dhe Strategjitë kombëtare rreth edukimit për median dhe informacionin në Shqipëri*.
www.institutemedia.org
- Byrne, S. (2009). Media literacy interventions: What makes them boom or boomerang? *Communication Education*, 58(1), 1–14. <https://doi.org/10.1080/03634520802226444>
- Carlsson, U. (2010). *Finland iceland norway Sweden denmark*.
www.nordicom.gu.se/clearinghouse
- Çela, E., Tufa, A., & Danglli, M. (2022). *ZHVILLIMI I SHKALLËS DHE MATJES E NIVELIT TË EDUKIMIT MBI MEDIAN DHE INFORMACIONIT TË STUDENTËVE NË SHQIPËRI*.
- Frau-Meigs, D. (2008). Media Literacy and Human Rights: Education for Sustainable Societies *. In *Medij. istraž.*
- Godhe, A. L. (2019). Digital literacies or digital competence: conceptualizations in nordic curricula. *Media and Communication*, 7(2), 25–35. <https://doi.org/10.17645/mac.v7i2.1888>
- Graham, R. J. (1989). Media Literacy and Cultural Politics. *SAGE Social Sciences Collections*, 39.
- Kahne, J., & Bowyer, B. (2019). Can media literacy education increase digital engagement in politics? *Learning, Media and Technology*, 44(2), 211–224.
<https://doi.org/10.1080/17439884.2019.1601108>
- Kellner, D., & Share, J. (2007a). Critical Media Literacy: Crucial Policy Choices for a Twenty-First-Century Democracy. *Policy Futures in Education*, 5(1), 59–69.
<https://doi.org/10.2304/pfie.2007.5.1.59>
- Kotilainen, S., & Arnolds-Granlund, S.-B. (2010). *The International Clearinghouse on Children, Youth and Media in cooperation with the Finnish Society on Media Education Media Literacy Education Nordic Perspectives*. [.nordicom.gu.se/clearinghouse](http://nordicom.gu.se/clearinghouse)

- Kupiainen, R. (2011). Finnish media literacy policies and research tendencies within a European Union context. *International Journal of Media & Cultural Politics*, 6(3), 335–341.
https://doi.org/10.1386/mcp.6.3.335_3
- Lee, L., Chen, D. T., Li, J. Y., & Lin, T. Bin. (2015). Understanding new media literacy: The development of a measuring instrument. *Computers and Education*, 85, 84–93.
<https://doi.org/10.1016/j.compedu.2015.02.006>
- Livingstone, S. (2011). *Media literacy: Ambitions, policies and measures*.
http://www.cost.esf.org/domains_actions/isch/Actions/IS0906-
- Ptaszek, G. (2019). Media Literacy Outcomes, Measurement. In *The International Encyclopedia of Media Literacy* (pp. 1–12). Wiley. <https://doi.org/10.1002/9781118978238.ieml0103>
- UNESCO. (2013). *Global Media and Information Literacy Assessment Framework: Country Readiness and Competencies*.
- Vraga, E., Tully, M., Kotcher, J. E., Smithson, A., & Broeckelman-Post, & M. (n.d.). A Multi-Dimensional Approach to Measuring News Media Literacy. In *Journal of Media Literacy Education* (Vol. 7, Issue 3). www.jmle.org